

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagimet/ 81 vite burg për çlirimtarët e Kosovës, nga Begaj te Albulena Haxhiu, të gjithë të zhgënjyer m e vendimin e Hagës
ADRESA	https://tpz.al/reagimet-81-vite-burg-per-clirimtar-et-e-kosoves-nga-begaj-te-albulena-haxhiu-te-gjithe-te-zhgenjyer-me-vendimin-e-hages-i333069
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:28:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:11:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c6e40c67bdc2bd3e5853f430f60252ef1f9ad96143fc8410915764df5a14831a
TEKSTI	e12faf0bfd6be1d19c63a37a8f30828d1d6334f9464303aa389a3bb8496eeb17
PAMJA	01b12a65f813bc2a0b61ff6da6f725fcbe6cde10aa4b256d8e9d02f90a36b962

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7a332798f70a2f19b1d0cc0cde51199a40f814ca5dd44f0c98f3eb9e33fbe1a
E MËPARSHMJA	2c39eb4f57c6e790721e370e44a3947aa4302fc855e38236b05313c6e3dbeb38
RRËNJA MERKLE	aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7a332798f70a2f19b1d0cc0cde51199a40f814ca5dd44f0c98f3eb9e33fbe1a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

13:56 "I padrejtë dhe i pamërituar"/ Vendimi i Hagës për liderët e UÇK, Berisha: Në Serbi ka festë, por asgjë nuk e errëson Luftën Çlirimtare të Kosovës • 13:48 Reagimi zyrtar/

AKTUALITET, 16 SEPTEMBER 2026, 13:11

Reagimet/ 81 vite burg për çlirimtarët e Kosovës, nga Begaj te Albulena Haxhiu, të gjithë të zhgënjyer me vendimin e Hagës

tpz.al TPZ



Vendimi i magistratëve të Hagës për të vulosur 81 vite burg në total për katërshen e UÇK-së ka shkaktuar irritim dhe dhjetëra reagime nga figura të njohura të politikës e jo vetëm.

Pas reagimit të kryeministrit Rama, i cili kundërshtoi haptazi vendimin e Hagës për të cilën theksoi se është marre për të dërguar prapa hekurave çlirimtarët e Kosovës, dy socialistë të tjerë kanë reaguar kundër këtij vendim.

Taulant Balla dhe Erion Braçe kanë shkruar se asnjë lloj vendimi nuk e zhbën dot historinë e Kosovës, për lirinë e të cilës luftuan pikërisht personat që sot u dërguan prapa hekurave. Dyshja socialiste bënë thirrje që shqiptarët të ngrenë zërin kundër këtij vendimi dhe të mos lejojnë njolllosja e Kosovës.

"KY VENDIM SOT NUK ËSHTË DREJTËSI! NUK ÇBËHET DOT HISTORIA E LAVDISHME E UÇK KËSHTU! PADREJTËSI! Shqiptarët duhet të mbrojnë UÇK. Duhet të mbrojmë lirinë dhe çlirimtarët nga ky vendim i padrejtë! Duhet të gjejmë të gjitha rrugët juridiko-ligjore të çbërjes së këtij vendimi, sepse duhet të mbrojmë me çdo kusht identitetin tonë si komb", shkruan Taulant Balla në reagimin e bërë vetëm pak minuta pas shpalljes së vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Deputeti socialist Erion Braçe ka reaguar ashpër pas dënimit të katër ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale në Hagë. Ai e cilësoi vendimin si një përpjekje për të njollësuar luftën çlirimtare, ndërsa kërkoi që Shqipëria dhe Kosova të ndërmarrin veprime ligjore kundër tij. Sipas Braçes, kjo nuk është më vetëm çështje e katër ish-drejtuesve të UÇK-së, por e çdo shqiptari.

"Në emër të popullit të Kosovës, një rivkatë bëri nis e ndvni luftën e shqiptarëve të Kosovës e

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionari" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë

Nga Preç Zogaj

Teje e Këtëj

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

Shqipërisë për liri e pavarësi, nder, dinjitet e jetë në paqe në trojet e tyre! Organizimi i popullit jo për të sulmuar kënd, por për t'u mbrojtur, për të mbrojtur vendin e pushtuar, lirinë e hequr dhunshëm, nderin e dinjitetin e marrë prej shtypjes, arrestimit, torturimit, përdhunimit të djemve e burrave, vajzave e grave, vrasjes, pra organizuar si UÇK, u quajt ndërmarrje kriminale!!!!

Domethënë, këta 4 burra, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, u vunë nën akuzë për krime kundër njerëzimit, u arrestuan për krime të tilla, u gjykuan për krime të tilla, por edhe kjo gjykatë nuk mundi t'i dënojë për to, nuk ka pasur kurrë krime të tilla! Shqiptarët, sa ka jetë mbi tokë, nuk kanë kryer krime të tilla, kurrë! Pas këtij vendimi, Shqipëria, e ndotur masivisht nga ky proces dhe ky vendim, duhet të ndërmarrë veprime ligjore të qarta kundër tij, për të pastruar emrin e saj, emrin e çdo shqiptari në ato dy rrethet e veriut që shquhen si vende krimesh në këtë vendim; duhet ta bëjë me shpejtësi kundër këtij vendimi të poshtër!

Kosova nuk ka nevojë për mendjen time, por dhe ajo duhet të ndërmarrë veprime ligjore në Kosovë mbi të gjitha dhe kudo, kundër një gjykate që në emër të popullit të Kosovës bën pis e ndyn një vend, një popull; kjo nuk është më çështje e katër burrave që luftuan për liri, të bërë fajtorë për krime lufte që nuk i kanë bërë kurrë, vrasjen e 96 personave konkretisht, por është çështje e një populli të shpallur fajtor pse iu përgjigj me luftë agresorit, pushtuesit! Tani është çështje shqiptare, e çdo shqiptari", shkruan Braçe.

Pas socialistëve, reagimi i radhës nga politika shqiptare ka ardhur nga presidenti Bajram Begaj i cili bën thirrje që të apelohej vendimi.

"Trishtim i thellë për vendimin e sotëm. Vendosmëria për të apeluar vendimin është shenjë e fortë integriteti dhe qëndrueshmërie. Për shqiptarët, askush dhe asgjë nuk njollos UÇK-në! Liria ka emër!" shkruan Begaj .

I zhgënjyer nga vendimi i Hagës ka reaguar dhe miliardi shqiptar Behgjet Pacolli i cili përmes një postimi të bërë mesditën e sotme në Facebook shkruan se kjo është një ditë e rëndë për familjarët e çlirimtarëve të Kosovës dhe të gjithë shqiptarët. Më tej Pacolli shpreh solidaritetin e tij për katër familjet të cilave iu thellua plaga e hapur para gjashtë vitesh, nga momenti kur ish-krerët e UÇK-së u dërguan në paraburgim.

"Zhgënjyese, e padrejtë e papranueshme, e dhimëshme e trishtueshme! Sot është një ditë e rëndë për Kosovën, për familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, për miqtë e për gjithë ne. Në këtë moment të vështirë, shpreh solidaritetin tim të sinqertë me familjet e tyre. Respektojmë procesin e drejtësisë dhe njëkohësisht besojmë në të drejtën e secilit për të kërkuar drejtësi deri në fund përmes ankimit. Qëndroni të fortë. Dhimbja juaj ndahet me ne dhe nga miljona njerëz. ???????

Përballë kësaj sfide, lufta për drejtësi duhet të përqendrohet tani në procesin e ankimit dhe në kundërshtimin e vendosur të kësaj padrejtësie" shkruhet në reagimin e bërë nga Behgjet Pacolli.

Reagime të ashpra kanë ardhur dhe nga politikanët e Kosovës, në mesin e të cilëve deri më tani Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka qëndruar në të njëjtën linjë me personat e sipërpërmendur, pasi kundërshton vendimin e Hagës.

Po ashtu, dhe Haxhiu i bashkohet mendimit se vendimi i duhur për këtë situatë do të ishte ankimi i vendimit.

"Aktgjykimi i sotëm dhe dënimet e shqiptuara ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit janë një goditje e rëndë për familjet e tyre, një lajm thellësisht tronditës për Republikën e Kosovës dhe një çast i rëndë për kombin shqiptar kudo që jeton.

Në një ditë si kjo, pesha e këtij vendimi nuk mund të ndahet nga historia prej së cilës kemi ardhur. Kosova e ka përjetuar mbi vete dhunën e një aparati shtetëror që vrau civilë, kreu masakra, dëboi qindra mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre dhe la pas mijëra të vrarë e të zhdukur. Kjo përvojë është pjesë e pashlyeshme e kujtesës së Kosovës dhe të kombit shqiptar.

Mendimet e mia janë, para së gjithash, me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup

Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Prej vitesh ato mbajnë barrën e mungesës, pritjes dhe pasigurisë. Dënimet e sotme e bëjnë këtë barrë edhe më të rëndë. Atyre ua përcjell nga Kosova një porosi, qëndroni të fortë, Kosova është me ju. Fjala e fundit juridike nuk është thënë. E drejta e ankimit është pjesë e procesit dhe duhet të ushtrohet plotësisht.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte çlirimtare. Ajo lindi përballë shtypjes, dhunës dhe krimeve të regjimit të Serbisë ndaj popullit të Kosovës. Asnjë aktgjykim nuk mund ta ndryshojë natyrën e asaj lufte dhe as të zhbëjë të drejtën e një populli për të luftuar për lirinë e vet. Respekti për drejtësinë nuk nënkupton heshtje përballë çdo përpjekjeje për ta shtrembëruar historinë. Nuk duhet lejuar që dënimet e sotme të përdoren për të relativizuar krimet e regjimit të Serbisë, për ta zvogëluar përgjegjësinë për to apo për të krijuar një narrativë të rreme.

Këtë qartësi e presim edhe nga miqtë dhe aleatët tanë. Sot na duhet qetësi, dinjitet dhe bashkim. Dhimbja e kësaj dite nuk duhet të na ndajë. Republika e Kosovës do ta përballojë edhe këtë sprovë duke i qëndruar besnike drejtësisë, lirisë dhe së vërtetës së saj. Sepse aktgjykimet nuk mund ta gjykojnë historinë e një populli as nuk mund ta rishkruajnë atë", shkruan Haxhiu në reagimin e saj.

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, ka reaguar pas dënimit të katër ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale në Hagë. Bardhi e ka cilësuar vendimin si "të pabesueshëm" dhe "të papranueshëm", duke e përshkruar këtë ditë si "të rëndë për kombin shqiptar" dhe, sipas tij, edhe më të rëndë për njerëzimin dhe botën demokratike.

"E PABESUESHME! E PAPRANUESHME! Ditë e rëndë për kombin shqiptar, por akoma më e rëndë për njerëzimin dhe botën demokratike. Shqiptarët janë edhe më të fortë pas kësaj PADREJTËSIE DHE TURPI TË NJERËZIMIT!

Askush nuk mund ta bëjë pis luftën e drejtë për LIRINË E KOSOVËS. Përjetësisht me UÇK-në", reagon Bardhi!



AKTUALITET / 16 September 2026, 12:48

Kriza/ Rritja e ndjeshme e çmimit të karburanteve, ringrihet sërish Bordi i Transparencës

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:43

VIDEO/ Vijnë tensionet jashtë gjykatës speciale në Hagë, protestuesit e revoltuar sulmojnë policinë holandeze. Shqërohen disa prej tyre

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:38

Operacioni/ Shiste kokainë dhe kanabis në lokalin ku punonte si kamerier, arrestohet 18-vjeçari në Elbasan

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:28

VIDEO/ Shpërthen tensioni jashtë gjykatës speciale në Hagë, shqiptarët përplasen me policinë. Shoqërohen disa prej tyre

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:04

Shpallen të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por liderët e UÇK-së dënohen nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg

AKTUALITET / 16 September 2026, 11:52

Ish-krerët e UÇK-së dënohen rëndë nga "Specialja", reagon Rama: Marre!

AKTUALITET / 16 September 2026, 11:01

Trupi Gjykues i Gjykatës Speciale: Të paktën 303 persona u keqtrajtuuan nga anëtarë të UÇK-së

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:56

Kryesuesi i Panelit të Trupit Gjykues në Hagë: Kjo çështje gjyqësore nuk ka të bëjë me legjitimitetin e UÇK-së, por vetëm me përgjegjësi personale

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:54

Gjyqi në Hagë/ Rrëzohen akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndai

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:49

Credins bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!

popullatës civile për krerët e UÇK-së

Artikull Promocional

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:40

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:26

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.